

RELACION I PROJEKTLIGJIT “PËR LIRIMIN E FREKUENCAVE TË DIGITAL DIVIDENTIT DY (DD2)”

I.QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për lirim të frekuencave të Digjiital Divident dy (DD2)”, është bashkëpropozim i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në pikën 2 të nenit 100, të Kushtetutës dhe nenin 9 të ligjit nr. 54/2024 datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 22 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Projektakti ka si qëllim të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve televizive, që transmetohen nëpërmjet rrjeteve tokësore, pas lirimit të brezit 700 MHz, përmes kompensimit të pjesshëm të kostove neto shtesë/direkte që shkakton procesi i lirimit të brezit 700 MHz.

Lirimi i frekuencave të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive dhe kalimi i tij për përdorime për rrjetet e komunikimeve elektronike të lëvizshme broadband ka si qëllim zbatimin e Vendimit të Bashkimit Evropian për brezin UHF, Vendimi (EU) 2017/899 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 17 Maj 2017, mbi përdorimin e brezit të frekuencave 470-790 MHz në Bashkimin Evropian. Zbatimi i Vendimit të BE për brezin UHF është kërkesë në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian, e përcaktuar në dokumentin e pozicionit të përbashkët negociues për Grupkapitullin e tretë, në lidhje me kërkesat për Kapitullin 10, “Transformimi Digjital dhe Media”.

Tjetër qëllim është të krijojë kushtet për lirim të Digjital Dividentit Dy (DD2), që përdoret aktualisht për transmetime audiovizive dhe vënien e frekuencave të tij në përdorim të rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme, rrjetet 5G sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike dhe të përcaktojë masën e kompensimit financiar, mënyrën e krijimit të saj, kategoritë që përfitojnë, mënyrën e kompensimit, procedurën e administrimit dhe të pagesave. Gjithashtu me lirim të frekuencave të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive synohet zgjidhja e problemit të interferencave me vendet fqinje.

II.VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji, nuk është parashikuar në Programin Analitik të Akteve, të miratuar për vitin 2025, por ka dalë si një nevojë për zgjidhjen e një problemi të rëndësishëm me interes të lartë publik, sikurse është garantimi i së drejtës së informimit, nëpërmjet vijimit të marrjes së shërbimeve mediatike pas kalimit të plotë në transmetimet numerike ***si dhe për përmbushjen e kushteve të integrimit të përcaktuara në dokumentin e pozicionit të përbashkët negociues për Grupkapitullin e tretë, në lidhje me kërkesat për Kapitullin 10, “Transformimi Digjital dhe Media”.***

III.ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për lirim të frekuencave të digital dividendit dy (DD2)”, synon të rregullojë vazhdimësinë e shërbimeve të medias audiovizive pas lirim të brezit të frekuencave 700 MHz, dhe të hapë rrugën për përdorimin e tyre për zhvillimin e rrjeteve me shpejtësi shumë të lartë 5G të së ardhmes.

Me VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit” ishte parashikuar lrimi i frekuencave të Digital Dividentit dy (DD2), në afatin maksimal të vendosur nga Komisioni Evropian me Vendimin nr. 2017/899/EU, brenda datës 30.6.2022.

Lirimi i brezit DD2 përbën një proces kompleks që ndërthur çështje teknike, ligjore, rregullatore, koordinim ndërkufitar me shumë vende, dhe ka implikime financiare për operatorët që janë licensuar dhe kanë investuar për ndërtimin e rrjeteve të transmetimit numerik mbi bazën e licensave të lëshurara nga AMA.

Lirimi i brezit DD2 nga përdorimi aktual për shërbimet audiovizive synon gjithashtu të zgjidhë problemin e interferencave me vendet fqinje, si Itali, Greqi, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroaci, që aktualisht e kanë licensuar këtë brez për rrjetet 5G në përputhje me Vendimin e Komisionit Evropian nr. 2017/899/EU.

Projektligji synon arritjen e objektivit strategjik për një shoqëri gigabit, përmes mundësisë të zhvillimit të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë për nevojat të së ardhmes. Miratimi i këtij projektligji është i rëndësishëm për sigurimin e vijimit të ofrimit të shërbimeve të medias audiovizive numerike përmes kompensimit financiar të pjesshëm për kostot e migrimit si dhe ***për përmbushjen e kushteve të integritetit të përcaktuara në dokumentin e pozicionit të përbashkët negociues për Grupkapitullin e tretë, në lidhje me kërkesat për Kapitullin 10, “Transformimi Digjital dhe Media”.***

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore për propozimin e këtij projektligji, sipas hierarkisë ligjore, është përmbledhur në:

- nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se: “Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës”.
- nenin 26, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, i cili përcakton se: “Projektaktet, që u përkasin institucioneve të tjera qendrore, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit përkatës, paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, me propozimin e Kryeministrit ose të ministrave përkatës”.

– pikën 3, të rregullores së Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të ndryshuar, sipas të cilës “të drejtën për të propozuar projektakte për shqyrtim në Këshillin e Ministrave e kanë Kryeministri dhe çdo ministër”.

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon transpozimin e ndonjë acquis të posacme por është në harmoni dhe në zbatim të Vendimit të Komisionit Evropian 2017/899/EU për lirimin e frekuencave të njohura si DD2.

Projektligji “Për lirimin e frekuencave të digjital – dividendit 2”, lidhet me zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e BE-së për Shqipërinë për Kapitullin 10, si dhe me ***përbushjen e kushteve të integritit të përcaktuara në dokumentin e pozicionit të përbashkët negociues për Grupkapitullin e tretë, në lidhje me kërkesat për Kapitullin 10, “Transformimi Digjital dhe Media”.***

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ligji është i organizuar në 10 nene dhe dy lidhje.

Në nenin 1, “*Qëllimi i ligjit*” është të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve televizive, që transmetohen nëpërmjet rrjeteve tokësore pas lirimit të brezit 700 MHz, përmes kompensimit të pjesshëm të kostove direkte që shkakton procesi i lirimit të brezit 700 MHz dhe krijimi i kushteve për lirimin e Digital Dividentit Dy (DD2), që përdoret aktualisht për transmetime audiovizive, dhe vënien e frekuencave të tij në përdorim të rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme, sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike.

Në nenin 2, përcaktohet “*Objekti i ligjit*”, qartësuar se projektligji përcakton masën e kompensimit financiar, mënyrën e krijimit të saj, kategoritë që përfitojnë, mënyrën e kompensimit, procedurën e administrimit dhe të pagesave.

Në nenin 3, “*Përkufizimet*” jepen përkufizimet e përdorura në projektakt.

Në nenin 4, “*Fusha e zbatimit*” sqarohet zbatimi i ligjit për mbulimin e pjesshëm të kostove të drejtperdrejta që shoqërojnë lirimin e brezit 700 MHz lidhur me rrjetet e transmetimeve numerike kombëtare të operatoreve të licensuar nga AMA dhe rrjetet e transmetimeve numerike të RTSH-së dhe kostot për planin e komunikimit.

Në nenin 5, “*Kompensimi financiar*”, përcaktohet masa e kompensimit financiar, për procesin e lirimit të brezit 700 MHz. Përcaktohet se kompensimi financiar jepet nga buxheti i shtetit, në formën e transfertës, Autoritetit të Mediave Audiovizive. Nënvizohet se në kompensimin financiar përfshihet dhe kosto e komunikimit për informimin e publikut për ndryshimet që ndodhin në kanalet e transmetimit sipas zonave të migrimit. Informimi i publikut është pjesë e rëndësishme për të garantuar marrjen e shërbimeve të medias audiovizive. Kompensimi për secilin prej operatorëve të rrjeteve numerike kombëtare të licensuar nga AMA, aktualisht

përdorues të frekuencave të brezit 700 MHz, si dhe për rrjetet e transmetimeve numerike të RTSH-së, detajohet në tabelën e vlerësimit të kostove në lidhjen 1.

Në nenin 6, “*Ndarja dhe përdorimi i kompensimit financiar*”, sqarohet në detaje sesi ndahet dhe përdoret masa e kompensimit financiar, sipas përcaktimeve të nenit 5, të këtij ligji dhe se cili institucion bën shpërndarjen.

Në nenin 7, “*Mënyra e administrimit të kompensimit financiar*”, sqarohet procedura e administrimit dhe fakti se kryhet nga AMA, e cila pas përfundimit të procedurës sipas detyrimeve që rrjedhin nga ky projektligj, raporton për pagesat e kryera, në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën. AMA gjithashtu do të bëjë verifikimet për lirimin e brezit të frekuencave të DD2.

Në nenin 8, “*Kthimi i kompensimit financiar*”, parashikohet që pas liritimit frekuencat e Digital Dividend 2, i kalojnë në administrim AKEP-it. Gjithashtu përcaktohet që AKEP do japë në përdorim frekuencat që lirohen për rrjete të komunikimeve elektronike të lëvizshme 5G, sipas parashikimeve në ligjin për komunikimet elektronike. Nga ky proces priten të ardhura për buxhetin e shtetit. Kompensimi financiar i parashikuar për migrimin e frekuencave të DD2, për t’u përballuar nga buxheti i shtetit, do t’i kthehen buxhetit të shtetit përmes të ardhurave që përfitohen nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të caktuara për rrjete të gjeneratës së ardhme 5G.

Në nenin 9, përcaktohen institucionet kryesore për zbatimin e këtij ligji, që janë AMA, ministria përgjegjëse për infrastrukturën, ministria përgjegjëse për financat, dhe AKEP.

Në nenin 10, parashikohet hyrja në fuqi e ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Projektligji shoqërohet me dy lidhje. Në lidhjen 1, bashkëlidhur jepet tabela me vlerësimin e kostove për secilin operator të rrjeteve numerike kombëtare që preket nga procesi i liritimit të frekuencave të brezit 700 MHz të llogaritura sipas metodologjisë së unifikuar e përdorur nga disa vende të BE-së dhe e rekomanduar nga asistenca teknike e financuar nga BE. Tabela me vlerësimin e kostove bazohet në rezultatet e asistencës teknike për këtë qëllim. Gjithashtu për të adresuar nevojën e liritimit të kanalit 37 në brezin e DD2, aktualisht i licensuar nga AMA për një transmetues lokal, është propozuar që në kompensimin për RTSH-në përfshihet detyrimi për mbartjen e programeve të operatorit të transmetuesit numerik lokal i licensuar për përdorimin e kanalit 37, për një periudhë tranzitore deri në 24 muaj sipas përcaktimeve të bëra nga AMA. Ky propozim i AMA, bazohet në eksperiencën e mëparshme të ndjekur në lirimin e brezit 800 MHz për kompensimin e operatorëve lokalë.

Në lidhjen 2, të projektligjit është prezantuar metodologjia e përdorur për llogaritjen e kompensimit. Metodologjia e llogaritjes së kostove të kompensimit bazohet në praktikën e mira të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian dhe rezultatet e asistencës teknike të ofruar nga ekspertët e Bashkimit Evropian. Metodologjia mban parasysh stacionet e transmetimit sipas konfigurimit të rrjetit/eve ekzistuese dhe fuqisë së transmetimit të tyre si dhe çmimeve referuese për transmetuesit sipas fuqisë së transmetimit. Metodologjia i ndan transmetuesit në disa grupe sipas fuqisë së transmetimit dhe merr parasysh situatën aktuale, investimet e kryera të rrjetit/eve mbi bazën e raportimit të kryer nga vetë operatorët si dhe verifikimet e kryera nga AMA.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e Aktit janë Autoriteti i Mediave Audiovizive, Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë, Ministria e Financës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Në hartimin e tij janë mbajtur parasysh eksperiencat ndërkombëtare, dhe rezultatet e asistencës teknike të BE-së me projektin: Technical Assistance for The Telecommunications Sector, Specific Contract number: 300026749 — SIEA-2018-5578.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është përgatitur bazuar në rezultatet e asistencës teknike të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit Technical Assistance for The Telecommunications Sector, Specific Contract number: 300026749 — SIEA-2018-5578, dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, është diskutuar në Grupin Ndërinstitucional të Punës/sekretariatit teknik të ngritur me Urdhër të KM nr. 113 datë 20.7.2022 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për lirimin e Digital Divident Dy”.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon shpenzime buxhetore në vlerën 5.137 milion Euro, të cilat pritet të kompensohen nga të ardhurat që do krijohen për dhënie në përdorim të frekuencave që lirohen dhe frekuencat e caktuara për rrjetet 5G. Në tërësi, procesi parashikon të ketë rritje të të ardhurave në buxhetin e shtetit, pasi lidhet me lirimin e brezit të rëndësishëm të frekuencave të DD2, si dhe licensimin e frekuencave të tjera të lira dhe që janë caktuar për përdorim për rrjetet 5G. Nga licensimi i rrjeteve 5G në brezin e frekuencave 3.4 GHz të realizuar në vitin 2024, u dhanë për buxhetin e shtetit mbi 10.872 milion Euro.